

Shkolla 9-vjeçare “Lidhja e Prizrenit” Shijak



Lënda: Gjuha shqipe

Klasa 2

Tema mësimore:

Unë kam,ti ke (ora e II)

Situata e të nxënit:

Përdorimi i foljes kam në
fjali në kohën e tashme
në situata të ndryshme .

Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës dhe temës mësimore

Nxënësi/ja:

- . **-Zgjedhon** saktë foljen *kam* në të gjitha vetat e kohës së tashme;
- . **-Përshtat** foljen me përemrin vetor përkatës në fjali;
- . **-Zëvendëson** emrat e njerëzve/sendeve me përemrat e duhur (Ai, Ajo, Ata, Ato);
- . **-Dallon** kuptimin e foljes *jam* (identitet) nga folja *kam* (zotërim).

Fjalët kyç:

folja kam,

vetë,

numri
njëjës,

shumës


kohë

Burimet dhe materialet didaktike: Teksti shkollor (f. 198), fisha me përemra dhe forma të foljes *kam*, mjete shkollore (lapsa, libra, çanta).

Lidhja me fushat e tjera: Gjuhët dhe komunikimi

Metodologjia: Diskutim, Punë interaktive me Smart Lab, Analiza krahasuese Punë në grup

Kujtojmë së bashku :
Cfarë është folja ?



-Kemi mësuar që folja **Kam** përdoret e pavarur në fjali, në këtë rast ajo tregon cfarë ke ti, zotërim të një sendi objekti etj.

-Ka raste kur ajo përdoret e shoqëruar me një folje tjetër nga pas

-Këtu kemi thënë që ajo ka rolin e foljes ndihmëse

-Sot do ta shohim përsëri foljen kam si folje e cila tregon zotërim

Folja **kam** ndryshon formën e saj sipas vetave

Rikujtojmë së bashku zgjedhimin e foljes kam

Numri Njëjës

- Veta e parë: **Unë** kam
- Veta e dytë: **Ti** ke
- Veta e tretë: **Ai / Ajo** ka

• Numri Shumës

- Veta e parë: **Ne** kemi
- Veta e dytë: **Ju** keni
- Veta e tretë: **Ata / Ato** kanë

Ti Ai/ajo Ne Ju Unë Ata/ato

1. Shkruaj për emrat: unë, ti, ai/ajo, ne, ju, ata/ato në vendin e duhur.

ke një lepur të butë.

ka një gëzof të bukur.

keni një shtëpi prej druri në mal.

kam një bluzë të trashë.

kemi një shtëpi të madhe në fshat.

kanë një fermë të madhe

Ush.2. Vendos foljen kam ashtu si duhet në fjalitë e mëposhtme:

Ka kishte kam ke keni kanë

Ai një lepur. Ata peshq
të kuq. Ju një qen të madh. Ti
..... një miush të bardhë. Ne
pëllumba. Unë një gjel dhe disa pula.